

## AKTI I THEMELIMIT

### I

#### SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### “MILIS ENERGY”

##### Neni 1 Emërtimi

- 1.1 Emërtimi i shoqërisë është “**MILIS ENERGY**” Sh.P.K., më poshtë e referuar si “Shoqëria”.

##### Neni 2 Themelimi

- 2.1 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar, të administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- 2.2 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me ligjin Shqiptar, me Statutin dhe Aktin e Themelimit.

##### Neni 3 Selia

- 3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Lezhë, Kolsh, PATALEJ Ruga "Kuvendi i Arberit", km 2 , Patale, Z.K.2886, nr pasurise 625/1, Lezhë, Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund të hapë dhe mbajë degë dhe/ose të kryejë aktivitete në vende të tjera, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë si dhe të hapë ose mbyllë zyra në vende të ndryshme përvëç selisë së Shoqërisë brenda territorit shqiptar.

##### Neni 4 Ortaku i Vetëm

- 4.1 Ortaku i vetëm i Shoqërisë është:

- **Z. Zef Shtjefni**, shtetas shqiptar, lindur në Patalej, më 10.04.1960, mbajtës i kartës së identitetit nr. 034837104, dhe numër personal G00410383B, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i cili diponon një kuote me kapital 100.00 (njëqind) Lekë.



## **Neni 5 Kapitali Themeltar**

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën 100.00 (njëqind) Lekë, i përbërë në një kuotë me vlerë 100.00 (njëqind) Lekë. Kapitali themeltar është nënshkruar plotësisht nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.
- 5.2 Kuotat, me vendim të Ortakut të Vetëm, janë lirisht të transferueshme tek çdo individ ose person juridik nëpërmjet kontratës së shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit ose nëpërmjet çdo mënyrë tjeter të parashikuara nga ligji. Transferimi i plotë ose i pjesshëm i kuotave të zotëruara në kapitalin e Shoqërisë do të kryhet me anë të një akti notarial.

## **Neni 6 Objekti**

- 6.1 Objekti i Shoqërisë është:

- Prodhimi i energjise elektrike permes shftyezimit te metodave te ndryshme teknologjike, veçanerisht i metodave qe shfrytezojne burimet e rinovalueshme natyrore. Shoqeria gjithashtu mund te ndertoje edhe impiantet e prodhimit te energjise elektrike, te realizoje menaxhimin, operimin, administrimin dhe shfrytezimin e tyre, te realizoje kerkime ne fushat e energjise se rinovalueshme, trajnime dhe bashkepunime te ndryshme, te financoje organizata joftimprurese, institucionet universitare dhe akademike dhe aktivitetet te tjera ne fushen e energjise se rinovalueshme, te bashkepunojme me organet publike, shteterore, qendrore dhe/ose vendore, me subjekte dhe organizata kombetare dhe nderkombetare per realizinin e aktivitetit te saj, etj.
- 6.2 Gjithashtu, Shoqëria mund te kryejë çdo aktivitet tjeter biznesi, i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

## **Neni 7 Kohëzgjatja**

- 4.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

## **Neni 8 Kompetencat e Ortakut të Vetëm**

- 8.1 Ortaku i Vetëm, në përputhje me ligjet shqiptare, mund të marrë, por pa u kufizuar, vetëm në: vendime për ndryshimin e Statutit, bashkimin me shoqëri të tjera,

zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, shndërrimin e shoqërisë në forma të tjera të parashikuara në ligj, transferimin e plotë ose të pjesshëm të kuotave, emërimin dhe shkarkimin e administratorit, emërimin e ekspertit kontabël, miratimin e llogarive vjetore dhe të pasqyrave financiare, likuidimin e Shoqërisë, emërimin e likuidatorit.

#### **Neni 9 Administrimi i Shoqërisë**

9.1 Administratori i parë i Shoqërisë është:

- **Z. Pashko Smaçi**, shtetas shqiptar, lindur në Pllane, më 08.04.1955, mbajtës i kartës së identitetit nr. 034039868, she numër personal F50408068H, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.
- 9.2 Administratori/ët emërohet/n me Vendim të Ortakut të Vetëm për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. Administratori (ët) mund të riemërohet (n) me Vendim të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë për të njëjtën periudhë.

#### **Neni 10 Ligji i Zbatueshëm**

10.1 Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj në përputhje të plotë me ligjin shqiptar.

10.2 Çdo konflikt qe mund të lindë mes ortakëve të Shoqërisë do të zgjidhet me mirëkuptim, ne rast të kundërt mosmarrëveshja do të jetë objekt i zgjidhjes nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky akt themelimi u hartua në katër kopje të njëjtë në gjuhën shqipe.

Lezhë, më datë 26.11.2024

**ORTAKU I VETËM**

Z. Pashko Smaçi  
J. R. L.